

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) dhe në bazë të nenit 25 paragrafit 2 dhe paragrafit 5 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 dhe 24/13), si dhe në bazë të nenit 6 dhe nenit 7, paragrafit 1, alinesë 4 të Ligjit për zhvillimin e arsimit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13), ministri i Arsimit dhe Shkencës e caktoi Programin mësimor për *shkencat natyrore* për klasën e II në arsimin fillor nëntëvjeçar.

CambridgeInternationalExamination

Byroja e zhvillimit të arsimit

PROGRAM MËSIMOR

SHKENCAT NATYRORE

për klasën e II

Arsimi fillor nëntëvjeçarë

Shkup, shkurt 2014

Hyrje

Programi mësimor i shkencave natyrore për klasën e dytë në arsimin fillor nëntëvjeçar është marrë nga Qendra Ndërkombëtare e programeve mësimore (Cambridge International Examination) dhe adaptuar nga Byroja e zhvillimit të arsimit. Lejimi i adaptimit të programeve mësimore është marrë nga ekspertë të Qendrës Ndërkombëtare të programeve mësimore (Cambridge International Examination).

Programi mësimor ngërthen në vete përmbledhje të qëllimeve zhvillimore mësimore nga lëmi i shkencave natyrore. Në ato hollësisht bëhet përshkrimi çka duhet të dijë nxënësi ose çka do të duhej të mund të bëjë për çdo vit në arsimin fillor. Objektivat mësimore sigurojnë strukturë për mësimdhënie dhe mësim nxënie dhe rekomandim për të cilat aftësitë dhe njohuritë e nxënësit mund të kontrollohen.

Programi mësimor i shkencave natyrore për arsimin fillor në katër lëmit përmbajtjesore: hulumtim shkencor, biologji, kimi dhe fizikë. Hulumtimi shkencor përfshin shqyrtimin e ideve, vlerësimin e dëshmive, planifikimin e punës hulumtuese dhe evidentimin dhe analizën e të dhënave. Hulumtimi shkencor i përforcon: biologjinë, kiminë dhe fizikën të cilat , gjithashtu, janë të fokusuara në zhvillimin e vetëbesimit dhe interesimit për arritje të njohurive shkencore.

Programi mësimor duhet të realizohet me fond prej 2 orë në javë, përkatësisht 72 orë në vit.

Pjesët nga programi mësimor që kanë të bëjnë me vlerësimin, kushtet hapësinore për realizimin e mësimimit dhe normativin për kuadrin mësimor janë dhënë në mënyrë plotësuese në pajtim me nenin 25 paragrafi 5 të Ligjit për arsim fillor.

Programi mësimor për klasën e II

1. Lëmit dhe rezultatet e arritura

Hulumtimi shkencor

Idetë dhe dëshmitë:

- idetë dhe dëshmitë përmes vëzhgimit kur tenton të përgjigjet për ndonjë çështje shkencore;
- shfrytëzon përvoja të përditshme për shembull vëzhgimi i shkrirjes së akullit;

Planifikimi i punës hulumtuese të informatave:

- parashtron pyetje dhe propozon; mënyra se si të përgjigjen;
- parashikon se çka do të ndodhë para se të vendosë diçka që të bëjë;
- njeh se për realizimin e shumëfishtë të qasjes konkrete ose krahasimit, kushtet duhet të jenë të njëjta.

Marrja dhe paraqitja e dëshmive:

- jep propozime për grumbullimin e dëshmive;
- flet për rreziqet dhe se si duhet shmangur;
- bën matje të thjeshta;
- vëzhgon dhe shkruan vëzhgime;
- Përdor mënyra të ndryshme që t'ju tregon edhe tjerëve se çka do të ndodhë.

Shqyrtimi i dëshmime dhe qasjet;

- bën krahasime;
- Identifikon shabllone të thjeshta dhe asociime;
- flet për parashikimet (me gojë dhe me shkrim), për rezultatet dhe se pse ajo ka ndodhur;
- shqyrton dhe sqaron se çka ka ndodhur

Biologji

Gjësendet e gjalla në mjedisin e tyre jetësor:

- identifikon ngjashmëri dhe dallime ndërmjet mjediseve lokale jetësore dhe mëson për disa nga mënyrat se si ato ndikojnë te shtazët dhe bimët të cilët janë rreth tyre;
- i kupton mënyrat për kujdesin për mjedisin jetësor, mund të shfrytëzohen burime sekondare: enciklopedi, internet, CD;
- e vëzhgon dhe e sqaron vëzhgimin në kohë dhe shkruan të dhëna për karakteristikat kohore.

Kimi

Vetitë e materialeve:

- njeh disa lloje të shkëmbinjve dhe përdorimin e tyre;
- din se disa materiale krijohen përmes rrugës natyrore, ndërsa tjerët janë të krijuara nga njeriu.

Ndryshimet te materialet:

- din se si forma e disa materialeve mund të ndryshohet me britmë, rrotullim/ose zgjatje;
- hulumton dhe përshkruan se si disa materiale të përditshme ndryshohen kur nxehen ose ftohen;
- njeh se disa materiale mund të treten në ujë.

Fizikë

Drita dhe errësirë:

- i identifikon burimet e ndryshme të dritës, duke e inkuadruar Diellin, si burim i madh i dritës;
- e din se errësira është mungesë e dritës;
- aftësohet që të identifikojë hije;

Energjia elektrike:

- njeh elemente të qarqeve të thjeshta elektrike të cilët kanë burime të rimës (për shembull.bateri);
- din se si ndërprerësi mund të përdoret që ta ndërpresë qarkun e rrymës.

Toka dhe hapësira rreth sajë:

- hulumton se si Dielli lëviz si hije gjatë ditës dhe si ndryshojnë hijet;
- përpunon model për atë se si rrotullimi i Tokës sjell deri në dukurinë e ditës dhe natës për shembull me topa me madhësi të ndryshme dhe llambë me bateri.

2. Objektivat konkrete, veprimtaritë dhe mjetet e punës

Qëllimet në programin mësimorë në shkencat natyrore janë të grupuara në gjashtë njësi tematike të cilat janë të dhëna sipas renditjes së caktuar, por mundet lirisht të realizohet me nxënësit ashtu si ofrohen kushtet lokale, mjetet dhe materialet për mësim nxënies. Qëllimet e hulumtimit shkencor përsëriten, paraqiten në secilën temë dhe janë të theksuara në veçanti në fillim të secilës temë. Në programin mësimor për klasën e dytë ka gjashtë tema të cilat mundësojnë qasje në mësim nxënies e përmbajtjeve mësimore që të paraqesin metoda të mundshme dhe aktivitete për realizim të suksesshëm të programit.

Drita dhe errësira	Ndryshimi i materialeve	Gjithësia
Energjia elektrike	Vështrimi i shkëmbinjve	Bimët dhe kafshët rreth nesh

Drita dhe errësira

Kjo temë ju ndihmon nxënësve që të kuptojnë se kemi nevojë nga drita që t'i shikojmë gjësendet. Nxënësit do të mësojnë se errësira është mungesë e dritës.

Disa nxënës mund të kuptojnë se në mungesë të dritës burimet tjera të dritës mund të shikohen më lehtë. Nxënësit kanë mundësi ta ndërlidhin kuptimin e vetë shkencor me përvojat e përditshme për errësirën dhe dritën.

Mund të bëhet ndërlidhja me arsimin fizik në kuptimin e të menduarit për shëndetin dhe sigurinë.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- dhënien e rekomandimeve për atë se si të hulumtohen idetë;
- vëzhgimet dhe krahasimet;
- sqarimet e mendimeve të tyre.

Objektivat e mësim nxënies	Nocionet
<p>Idetë dhe dëshmitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - grumbullon dëshmi me vëzhgim kur tenton të përgjigjet ndonjë pyetje shkencore; - shfrytëzon përvoja të përditshme për shembull. vëzhgimi i shkrirjes së akullit; - shfrytëzon burime të thjeshta të informatave. <p>Marrja dhe paraqitja e dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none"> - jep propozime për grumbullimin e dëshmive; - flet për rreziqet dhe se si t’ju ikim; - vëzhgon dhe i evidenton vëzhgimet; - bën matje të rëndomta; - shfrytëzon mënyra të ndryshme që t’ju tregojë tjerëve se çka ka ndodhur. <p>Shqyrtimi i dëshmisë dhe qasja;</p> <ul style="list-style-type: none"> • bën krahasime; • identifikon model të thjeshta dhe asociime; • flet për parashikimet (gojarisht dhe në tekst), për rezultatet dhe vallë se ajo ka ndodhur; • shikon dhe sqaron se çka ka ndodhur. 	<p>Drita Errësira Dielli Llamba e xhepit</p> <p>Hulumtimi shkencor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shikon - shpjegon - pyet - qëllon - të drejtën - të padrejtën - mat - krahason

Objektivat e mësim nxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Aftësi që të identifikojë burime të ndryshme të dritës duke e përfshirë edhe Diellin.</p>	<p>Lexoni tregim apo vjershë për dritën dhe errësirën – ose lexoni tregim për qirinjtë.</p> <p>Fëmijët bisedojnë për përvojat e tyre gjatë natës. „Loja me diell” – në terrenin e sportit. Shkoni nëpër shkollë dhe kërkoni burime të dritës.</p> <p>Ndriçues për festivale dhe manifestime.</p>	<p>Libra me tregime për dritën dhe errësirën.</p> <p>Ditë me diell.</p> <p>Fotografi nga festivalet dhe manifestimet me ndriçim.</p>	<p>Fëmijët me të pare të kufizuar do të kenë nevojë për përkrahje të posaçme gjatë kohës së kësaj njësie – duke i ndje burimet e dritës si burime të ngrohtësisë ose përmes prekjes.</p> <p>Është e rëndësishme që arsimtarët t’ju ndihmojnë fëmijëve tjerë që të bëhen më të kujdesshëm për ata të cilët janë me të pare të kufizuar.</p> <p>SIGURI – Fëmijët duhet t’i shmangen zjarrit.</p>
<p>Mësojnë se errësira është mungesë e dritës.</p>	<p>Krijoni „ambient të errët” në klasën.</p> <p>Aktivitete me kuti të zezë/llambë xhepi.</p>		<p>Fëmijët shpesh nuk kanë përvojë me errësirë të plotë dhe ndonjëherë thonë se ata mundën të shikojnë në errësirë meqë ndriçimi i rrugëve e ndriçojnë hapësirën e tyre kur janë në krevat.</p> <p>VLERËSIMI</p> <p>Bëni natë/ditë, errët/dritë kolazh apo pikturë për shembull „Çka mund të shikojmë në dritën e ditës? Çka mundemi të shikojmë se kur është natë?”</p> <p>Diskutoni se çka paraqesin fotografitë e tyre.</p>

Objektivat e mësim nxënies	Aktivitetet	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Aftësi që të identifikojnë hije.	Hartimi i konceptit drita dhe errësira. Hulumtoni me shfrytëzimin e llambave të xhepit ose/burime të dritës.	Burimet TIK.	

Energjia elektrike

Kjo temë i ka informuar nxënësit me konceptin e energjisë elektrike dhe se si ajo funksionon në jetën e përditshme. Ajo njehërit i njofton me rreziqet e ndërlydhura me energjinë elektrike dhe se si të mbeten të sigurt.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- mendimin për atë se çka pritët që të ndodhë dhe vallë rezultatet e përkrahin;
- hulumtimi dhe testimi i makinave elektrike;
- vëzhgimi dhe sqarimi që është i zbuluar.

Objektivat e mësimi	Nocionet
<p>Idetë dhe dëshmitë:</p> <ul style="list-style-type: none">- grumbullon dëshmi kur tenton të përgjigjet ndonjë çështjet shkencore;- shfrytëzon përvoja për shembull vëzhgimi i shkrirjes së akullit;- shfrytëzon burime të zakonshme të informatave. <p>Planifikimi i punës hulumtuese:</p> <ul style="list-style-type: none">- parashtrimi i pyetjeve dhe propozon mënyra se si do të përgjigjen;- parashih se çka do të ndodhë para se të vendos. <p>Marrja dhe paraqitja e dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none">- jep propozime për grumbullimin e dëshmive;- flet për rreziqet dhe se si ai vëzhgon dhe i evidenton vëzhgimet;- bën matje të rëndomta;- shfrytëzon mënyra të ndryshme që t'ju tregojë tjerëve se çka ka ndodhur. <p>Shqyrtimi i dëshmisë dhe qasja;</p> <ul style="list-style-type: none">• bën krahasime;• identifikon model të thjeshta dhe asociime;• flet për parashikimet (gojarisht dhe në tekst), për rezultatet dhe vallë se ajo ka ndodhur;• shikon dhe sqaronë se çka ka ndodhur.	<p>Bateria</p> <p>Qelia</p> <p>Mbajtësi i baterisë</p> <p>Qarku i rrymës</p> <p>Ndriçueset</p> <p>Llambat</p> <p>Alarmi</p> <p>Teli/telat</p> <p>Konvektorët</p> <p>Ndërprerësit</p> <p>Hulumtimi shkencor:</p> <ul style="list-style-type: none">• kërkon• bën (përpunon)• qëllon (parashikon).

Objektivat e mësim nxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Aftësi që t'i njeh komponentat e qarkut të thjeshtë duke i inkuadruar qelitë (bateriet).	<p>Hulumtoni gjëra dhe aparate të cilat punojnë në bateri si për shembull. ndriçueset e xhepit. Vendosni bateritë si duhet që të funksionojnë gjërat.</p> <p>Bëni qark elektrik që të ndriçojë ndriçuesja dhe të ndizet alarmi.</p>	<p>Lodra/aparate të ndryshme me bateri me bateri të ndryshme.</p> <p>Pajisja për qarkun elektrik, bateri/mbajtës, tela, poçe elektrike, darë.</p>	
Mësim nxënia si ndërprerës mund të shfrytëzohet për ndërprerjen e qarkut të rrymës.	<p>Bëni që qarku të punojë. Provoni në skemat e ofruara Zbatoni në skemat e ofruara se vallë qarku punon apo nuk punon – kontrolloni atë që e zbatoni.</p> <p>Disejtoni dhe bëni qark elektrik i cili do të punojë për qëllim specifikues, për shembull ndriçimi i shtëpisë së kukullës.</p>		

Ndryshimi i materialeve

Përmes kësaj teme nxënësit mësojnë të bëjnë dallime ndërmjet gjësendit dhe materialit prej të cilit është i bërë.

Ata mësojnë për disa mënyra për të cilat materialet mund të ndryshohen me nxemje dhe ftohje.

Zbatimi i shkencës për gatim ju ndihmon që t' i kuptojnë rreziqet dhe se si të jenë të sigurtë.

Ata mësojnë se shkrirja dhe tretja janë të ndryshme dhe njoftohen se kur tretet materiali i ngurtë ai ende ekzistonë.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- të menduarit për atë se çka pritet të ndodhë;
- vëzhgimet dhe takimet dhe perceptimi i tyre;
- konkludimi se vallë parashikimi është i caktuar.

Objektivat e mësim nxënies	Nocionet
<p>Idetë dhe dëshmitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - grumbullon dëshmi kur tenton të përgjigjet ndonjë çështje shkencore; - shfrytëzon përvoja për shembull.vëzhgimi i shkrirjes së akullit; - shfrytëzon burime të zakonshme të informatave. <p>Planifikimi i punës hulumtuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> - parashtrimi i pyetjeve dhe propozon mënyra se si do të përgjigjen; - parashih se çka do të ndodhë para se të vendos. <p>Marrja dhe paraqitja e dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none"> - jep propozime për grumbullimin e dëshmive; - flet për rreziqet dhe se si t’ju shmangen rreziqeve; - vëzhgon dhe i evidenton vëzhgimet; - bën matje të rëndomta; - shfrytëzon mënyra të ndryshme që t’ju tregojë tjerëve se çka ka ndodhur. <p>Shqyrtimi i dëshmisë dhe qasja;</p> <ul style="list-style-type: none"> • bën krahasime; • identifikon model të thjeshta dhe asociime; • flet për parshikimet (me gojë dhe në tekst), për rezultatet dhe vallë pse ka ndodhur ajo; • shikon dhe sqaron se çka ka ndodhur. 	<p>Shtrydhje Material Formë Ndryshim Ftohtë Ngrohtë Palosje Rrokullisje Zgjatje Pika uji Shkrirje I ngurtë Material Natyror Artificial (joartificial)</p> <p>- Hulumtim shkencor:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zbulon • shpjegon • kërkon • qëllon (parashikon) • shkruan/vizatton • matë • krahason

Objektivat e mësimit	Veprimtaritë	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
Din se si format e disa materialeve mund të ndryshohen me palosje, përkule ose zgjatje.	Hulumtoni materiale – të modeluara prej argjiri, brumë (brumë me kryp).	Materializon. Modelon.	
Zbulon dhe përshkruan mënyra për të cilën disa materiale të përditshme ndryshohen kur janë të nxehta ose të ftohta.	<p>Bëni modele prej argjili dhe pjekni në furrë.</p> <p>Piqni ëmbëlsirë.</p> <p>Hulumtoni se si të bëni që kockat e akullit të shkrihen më shpejtë.</p> <p>Bëni katrorë me akull.</p> <p>Paraqitni ujë që shndërrohet në avull dhe me ftohje kthehet në pika uji.</p>	<p>Përbërësit dhe reçetat. Pajisje për pjekje.</p> <p>Akull në formë të katrorit.</p> <p>Tenxhere.</p>	<p>Përdorni argjil që thahet në ajr nëse nuk ka furrë.</p> <p>Përmbahuni dhe të jeni në përcjellje me rregulloren në shkollë për përgatitjen e ushqimit.</p>

<p>Din të njehë se disa materiale mund të treten.</p>	<p>Hulumtoni se çka ndodhë kur materiale të ndryshme për shembull: <i>kryp, kafe çasti, sheqer, miell, ngjyrë pluhur, shkumës ose lojë me rruzuj, stiropori</i> përzihet me ujë. Grupon materialet e ngurta në përputhje me atë që ndodhë, duke i shkruar rezultatet e tyre në tabelë.</p>	<p>Materiale të ndryshme të ngurta. Gota laboratorike/pla stike. Lugë.</p>	
<p>Din se disa materiale paraqiten në mënyrë natyrore, ndërsa disa në mënyrë artificiale.</p>	<p>Gruponi materialet/gjësendet në bazë të asaj se vallë janë artificiale apo natyrale.</p>	<p>Pjesë të materialeve dhe gjësende të bëra prej tyre.</p>	
		<p>Përdorimi i TIK.</p>	

Vështrimi i shkëmbinjëve

Nxënësit duhet të mësojnë se nën të gjitha sipërfaqet ka shkëmbinjë të cilët ata nuk do të kenë mundësi ta shikojnë. Ekzistojnë shkëmbinjë të ndryshëm me karakteristika të ndryshme.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- shfrytëzimin e përvojës së dorës së parë;
- shfrytëzimin e burimeve të thjeshta të informatave;
- vëzhgimet dhe caktimin e tyre;
- krahasimin

Objektivat e mësimnxënies	Nocionet
<p>. Idetë dhe dëshmitë:</p> <ul style="list-style-type: none">- grumbullon dëshmi kur tenton të përgjigjet ndonjë çështje shkencore;- shfrytëzon përvoja për shembull.vëzhgimi i shkrirjes së akullit;- shfrytëzon burime të zakonshme të informatave.. <p>Marrja dhe paraqitja e dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none">- vëzhgon dhe i evidenton vëzhgimet; <p>Shqyrtimi i dëshmisë dhe qasja;</p> <ul style="list-style-type: none">• bën krahasime;• identifikon model të thjeshta dhe asociime;	<p>Shkëmbinjë Guri Natyrore Artificiale (jonator)</p> <p>Trualli Rërishte</p> <p>Hulumtimi shkencor:</p> <ul style="list-style-type: none">• shikon• pyet• zbulon• shkruan/vizaton• tregon/ritregon• krahason• kontrollon

Objektivat e mësim nxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Din të njeh disa llojë shkëmbinj dhe përdorimin e shkëmbinjve të ndryshëm.</p>	<p>Diskutoni se ku janë shkëmbinj të natyrore dhe artificiale. Aktivitetet e grupimit dhe klasifikimi.</p> <p>Shfrytëzoni burime sekondare për identifikimin e përdorimeve specifike të shkëmbinjve të caktuar – dhe arsyetoni të mendurit e burimeve.</p> <p>Testimi i tokës – të shikuarit ellojeve të ndryshme të tokës për shembull: me rërë, argjil etj.</p>	<p>Fotografi të pejsazhëve botërore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesë nga shkëmbinj të. • Internet. • Libra. • CD. • Pjesë të llojeve të ndryshme të tokës. 	<p>Fjala gur ndonjëherë përdoret në vend shkëmbinj. Gurë dhe gurë të imët janë pjesë të vogla të shkëmbinjve.</p>

Ditë dhe natë

Në këtë temë nxënësit mësojnë për hijet, se si bëhen dhe se si mundën të ndryshohen.

Ata zbulojnë se vallë pse dhe se si ka ditë dhe natë.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- vëzhgim;
- hulumtimin e hijeve.

Objektivat e mësim nxënies	Nocionet
<p>Idetë dhe dëshmitë:</p> <ul style="list-style-type: none">- grumbullon dëshmi kur tenton të përgjigjet ndonjë çështje shkencore;- shfrytëzon përvoja për shembull.vëzhgimi i shkrirjes së akullit;- shfrytëzon burime të zakonshme të informatave.. <p>Marrja dhe paraqitja e dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none">- jep propozime për grumbullimin e dëshmive;- flet për rreziqet dhe se si ay;- vëzhgon dhe i evidenton vëzhgimet;- bën matje të rëndomta;- shfrytëzon mënyra të ndryshme që t'ju tregojë tjerëve se çka ka ndodhur. <p>Shqyrtimi i dëshmisë dhe qasja;</p> <ul style="list-style-type: none">• bën krahasime;• identifikon model të thjeshta dhe asociime;• flet për parshikimet (me gojë dhe në tekst), për rezultatet dhe vallë pse ka ndodhur ajo;• shikon dhe sqaron se çka ka ndodhur.	<p>Drita Errësira Dielli Llambë xhepi Hija Dita Nata Toka Hëna Rrotullimi</p> <p>Hulumtimi shkencor:</p> <ul style="list-style-type: none">• shikon• zbulon• shpjegon• tregon• shkruan/vizaton• krahason• matë

Objektivat e mësim nxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
<p>Hulumtimet se si paraqitet Dielli, si dhe pse ndryshohet pozita gjatë ditës dhe se si ndryshohen hijet.</p>	<p>Diskutoni me fëmijët për atë se vallë Dielli, kryesisht lëviz. Paraqitni me shfrytëzimin e modeleve, se hijet mund të ndryshohen gjatë ditës. Modeli për ilustrimin se sa është i lartë burimi i dritës aq është më e shkurtër hija dhe se si ndryshimi i pozitës relative të llambës së xhepit dhe bastuni e shkakton ndryshimin e gjatësisë së hijes. Eksperimente me hijen e shkophave.</p>	<p>Interneti apo libri.</p> <p>Ditë me diell – nxjerrin nxënësit jashtë në kohë të ndryshme që t'i shikojnë hijet.</p>	<p>Pohoni se dielli nuk lëviz.</p>
<p>Modelimi se si rrotullimi i Tokës na çon kah dita dhe nata, për shembull me madhësi të ndryshme të topave dhe llambave të xhepit.</p>	<p>Bëni lëvizje Toka/Dielli/Hëna me fëmijët duke i mbajtur topat me madhësi të ndryshme të distancave të ndryshme.</p>		

Bimët dhe shtazët rreth nesh.

Në këtë temë nxënësit mësojnë për bimët dhe shtazët në mjedisin e drejtpërdrejtë.

Ata njehërit mësojnë se si dallimet ndërmjet vendeve janë shumë afër njërit tjetrit, kanë dallime të bimët dhe shtazët.

Ata mësojnë se njësoj si njerëzit ashtu edhe bimët dhe kafshët tjera shumohen.

Ata mësojnë se si të veprojnë si duhet ndaj shtazëve, qenieve dhe mjedisit.

Hulumtimi shkencor fokusohet në:

- shndërrimin e ideve në pyetjet që mund të jenë të hulumtuara;
- prezantimin e rezultateve;
- nxjerrjen e përfundimeve.

Objektivat e mësim nxënies	Nocionet
<p>. Idetë dhe dëshmitë:</p> <ul style="list-style-type: none">- grumbullon dëshmi kur tenton të përgjigjet ndonjë çështje shkencore;- shfrytëzon përvoja për shembull.vëzhgimi i shkrirjes së akullit;- shfrytëzon burime të zakonshme të informatave.. <p>Marrja dhe paraqitja e dëshmive:</p> <ul style="list-style-type: none">- jep propozime për grumbullimin e dëshmive;- flet për rreziqet dhe se si ai i vëzhgon dhe i evidenton vëzhgimet;- bën matje të rëndomta;- shfrytëzon mënyra të ndryshme që t'ju tregojë tjerëve se çka ka ndodhur.	<p>Kafshët Bimët Organizmat e vegjël Mbeturat Shiu Dielli Me erë Me borë Me akull Me vranësira Rufeja</p>

Shqyrtimi i dëshmisë dhe qasja;

- bën krahasime;
- identifikon model të thjeshta dhe asociime;
- flet për parshikimet (me gojë dhe në tekst), për rezultatet dhe vallë pse ka ndodhur ajo;
- shikon dhe sqaron se çka ka ndodhur.

Me lagështi

E ngrohtë

Nxehtë

Ftohtë

Hulumtimi shkencor është:

- i njejtë
- i ndryshueshëm
- krahason
- qëllon (parashikon)
- grumbullon
- shikon
- shpjegon
- shkruan/vizaton
- matë

Objektivat e mësim nxënies	Veprimtaritë	Resurset (mjetet dhe materialet)	Komentet
.Identifikon ngjashmëri dhe dallime ndërmjet mjediseve lokale jetësore dhe din për mënyrat përmes të cilave ndikojnë te kafshët dhe bimët të cilët jetojnë aty.	Diskutoni se ku të gjeni kafshë dhe bimë rreth shkollës. Shkoni „në gjah” organizmave të vegjël bimët në oborrin e shkollës. Krahasoni dhe kundërshtoni dy vendbanime të ndryshme dhe paramendoni se çka do të gjeni atje.	Harta e terrenit sportiv në shkollë. Kavanoz për eksperimente. Dorëza.	Vendosni gurë, karabina etj., Disa ditë para se të shkoni „në gjah” organizma të vegjël. Të jeni të kujdesshëm. Mos i shqetësoni vendbanimet.
Kupton dhe bisedon për vëzhgimet për kohën i shkruan të dhënat e marra për kohën.	Si mund t’i ruajmë vendbanimet? ‘ka ndodh në mjedisin e drejtpërdrejtë që mund të shkatërrojë disa vendbanime? Vallë ndërtime të reja ndikojnë në mjedisin e drejtpërdrejtë? Shkoni t’i mbledhni mbeturinat.	Burime sekondare (internet, CD, enciklopedi) Dorëza	
Vëzhgon dhe bisedon për vëzhgimet për kohën, i shënon të dhënat e marra për kohën.	Përcaktoni parashikimin ditor të motit në trafikimin e klasës. Diskutoni dhe analizoni parashikimin e kohës.	Harta/tabela të bëra në mënyrë të pavarur ose tabela për parashikimin e motit. TIK baza e të dhënave.	

3. Vlerësimi i të arriturave të nxënësve

KONTROLLIMI DIAGNOSTIK DHE VLERËSIMI

Në fillim të vitit shkollor mësimit nxënësi bën kontrollimin diagnostik dhe vlerësimin e nxënësve me qëllim të dijë gjendjen në funksion të cilësisë së planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve të ardhshme. Kuptohen njohuritë paraprake të kuptimit të gjerë të fjalës, aspektet socializuese të zhvillimit, zhvillimi emocional dhe zhvillimi fizik.

VLERËSIMI FORMATIV- Në rrjedhën e mësimit nga shkencat natyrore në klasën e dytë rekomandohet ndjekja formative e cila përfshin përpunimin dhe udhëheqjen e shumë provave të nxënësve që përfshinë:

- mbledhjen e treguesve për secilin nxënës në veçanti;*
- lista të vazhdueshme (formative), të përgatitura paraprakisht, evolutive për çdo nxënës në veçanti, të cilat plotësohen pas aktivitetit të tyre konkret, e cila është specifike (pozitive ose negative) ose studime të rastit në të cilat mësimit nxënësi e vëren gjendjen faktike;*
- instrumente që kanë të bëjnë në secilin lëmi programor në veçanti dhe në të cilat mësimit nxënësi fut **të dhënat e të arriturave të nxënësit në të gjitha aspektet zhvilluese** të cilat nxiten me programin e shkencave natyrore (aspekti kognitiv-intelektual, socio-emocional dhe psikomotorik). *Listat evolutive kryesisht kanë të bëjnë me objektivat të cilat në tërësi arrihen në nivelin e klasës së II dhe nuk janë kalimtare për klasat më të larta.**

VLERËSIMI MIKROSUMATIV – Në mbarim të tremujorit të dytë, në bazë të njohurisë së vlerësimit formativ, realizohet vlerësimi mikrosumativ.

VLERËSIMI SUMATIV–Në bazë të dhënave të përgjithshme të fituara nga përcjellja dhe vlerësimi formativ mësimit nxënësi e konstaton (përshkruan) gjendjen zhvilluese të secilit nxënës në veçanti, në suaza të secilës lëmi programor.

ARRITSHMËRIA DHE ECURIA E PËRMBLEDHJES SË DËSHMIVE

- Për përmbledhjen e dëshmive gjatë një viti duhet të kenë qasje prindërit që të mund të kontribuojnë në realizimin cilësor të mësimit nga lënda e shkencave natyrore.
- Për notën përfundimtare analitike-përshkuese , gjithashtu duhet të kenë qasje prindërit dhe bëhet pjesë e përmbledhjes së dëshmive të nxënësit.
- Përmbledhja e dëshmive e nxënësit me të dhëna të pastruara dhe të përzgjedhura vazhdon në klasën (më të lartë) vijuese.

MËNYRAT E KONTROLLIMIT DHE VLERËSIMIT–Në pajtim me natyrën e programit të shkencave natyrore në klasën e dytë, kontrollimi dhe vlerësimi përshkruar duhet të realizohen me shkrim, në mënyrë praktike, përmes prezantimit, aktiviteteve dhe ushtrimeve përkatëse.

4. Kushtet hapësinore për realizimin e programit

Programi sa i përket kushteve hapësinore për realizim bazohet në Normativin për hapësirë për klasën e I, II dhe III dhe në mjetet mësimore për klasën e i miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Normativi për kuadrin mësimor

Mësimdhënien për shkencat natyrore në klasën e dytë mund ta realizojë:

- Profesori i mësimit klasor;
- Profesori për edukim parashkollor;
- Pedagog i diplomuar.

Nënshkrimi dhe data e verifikimit të programit mësimor

Programi mësimor për shkencat natyrore për klasën e dytë në arsimin fillor nëntëvjeçar, marrë dhe lejuar nga Qendra Ndërkombëtare e programeve mësimore (Cambridge International Examination) dhe përshtatur nga Byroja e zhvillimit të arsimit, e caktoi

më

Ministër

Spiro Ristovski